



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 211/1 prot.

Tiranë, më 13. 02. 2024

V E N D I M

Nr. 42, datë 13. 02. 2024

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 13, datë 01.02.2024, të D. K., kundër Policisë Bashkiake Tiranë, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar” dhe “çdo shkak tjetër”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues, në mes të tjerash informon se: “...Për këtë arsye më lejoni të shpreh hapur indinjatën time për faktin se makina ime një Fiat Panda Blu, u gjobit në rrugën “Zef Jubani” pak metra larg banesës sime. Ndihem i diskriminuar sepse po shoh që Policia Bashkiake ka dy standarde në vendosjen e gjobave. Makina ime e cila ishte parkuar atje prej dy javësh (e përdor vetëm për levizjet jashtë Tirane) nuk qe gjobitur asnjëherë më parë atje. Makina aktualisht është në emrin tim dhe unë informova për këtë efektivët e Policisë Bashkiake, të cilët më garantuan se makina nuk do gjobitej. Për më tepër, dhe duke qenë se e panë se unë jam një person me aftësi të kufizuara, më garantuan se do informonin për këtë kolegët e tyre dhe se nuk do ishte e nevojshme të merrja pullën e famshme. Në këtë pikë më lejoni të them se unë lëviz me biçikletë brenda Tiranës, kjo si informacion shtesë.

Një makinë e cila nuk gjobitet për dy javë me radhë nuk mund të gjobitet sipas qejfit të efektivëve të Policisë Bashkiake. Nëse do e kishin bërë të detyrueshme pajisjen time me pullë rezidenti unë do isha pajisur me pullë rezidenti. Por përtej kësaj është e qartë se diskriminimi vazhdon edhe më tej, duke qenë se siç duket edhe nga fotografitë që disponoj, makina e cila është parkuar fill pas makinës sime është gjithashtu pa pullën e rezidentit, por nuk është gjobitur. Më keq akoma një makinë e cila është e pajisur me kartën e rezidentit po në të njëjtën rrugë është gjobitur, siç duket edhe nga fotot që disponoj, kjo më bën të besoj se Policia Bashkiake nuk ka një standard për të gjithë por është selektive dhe kjo në vetvete përbën diskriminim.

Për më tepër Zona në fjalë është një zonë e mbipopulluar dhe kjo vështirëson gjetjen e një vendi parkimi për qytetarët. E megjithëse Policia Bashkiake është lajmëruar dhe vënë në dijeni për njerëz që zënë hapësira publike, duke marrë lek në mënyrë krejt të jashtëligjshme nga qytetarët, nuk ka bërë asgjë konkrete për të parandaluar fenomenin. Këtu do duhet shtohet edhe fakti se për bizneset në zonë ka vende të rezervuara sipas kërkesave që ato kryejnë, duke vështirësuar gjetjen e vendqëndrimeve për banorët. Edhe kjo më duket e padrejtë, pasi në ligjin “Për shfrytëzimin e hapësirave publike është e detyrueshme që ndërtuesit e pallatit dhe bizneset të sigurojnë parkime nëntokësore dhe jo të marrin parkime që do duhet të ishin për banorët aktual.

Në jetën time, jam udhëhequr gjithmonë nga ndjenja e solidaritetit. Për këtë dhe duke qenë se jam i punësuar për kaq shumë vite kam lënë me zgjedhje pagesën e aftësisë së kufizuar, por si një mbështetës i reformës që u bë disa vjet më parë nuk u dorëzova asnjëherë nga shërbimet të cilat në fakt nuk po i marrë. Kjo më bën të reflektoj edhe për vendimin e marrë disa vite më parë për të dorëzuar me vullnet të lirë pagesën e aftësisë së kufizuar, të cilën do duhej ta merrja që nga viti 2009 kur u ktheva në Shqipëri. Nëse unë krewa një detyrë, i bindur se si i privilegjuar i jetës, duke dashur të ndihmoj shtetin dhe vendin tim instancat shtetërore dhe vendimmarrëse nuk po sillet me reciprocitet karshi meje”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit të tij nga ana e Policisë Bashkiake Tiranë, anulimin e masës administrative me gjobë dhe sigurimin e një vend parkimi të rezervuar për personat me aftësi të kufizuara.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, që i jep të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sikurse parashikohet në këtë ligj.

Ligji nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar (LMD), garanton mbrojtje nga diskriminimi bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh. Në nenin 1 të LMD parashikohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Në nenin 3/1, të LMD parashikohet se: “Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Bazuar në nenin 7, pika 1, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë, që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës nr. 13, datë 01.02.2024, rezultoi se ajo nuk ishte e plotë për të vijuar më tej shqyrtimin e saj.

Për rrjedhojë, më datë 07.02.2024, në ambientet e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, u paraqit subjekti ankues ku i'u kërkua plotësimi i saj, veçanërisht në drejtim të provueshëmrisë së shkaqeve të pretenduara. Në vijim, referuar procesverbalit të takimit të mbajtur më datë 07.02.2024, ankuesi kërkoi të tërhiqej nga shqyrtimi i mëtejshëm i ankesës kundër Policisë Bashkiake Tiranë.

Në nenin 32, pika 3, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar përcaktohet: “3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, Komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj.

Në nenin 90/3 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikohet se: “Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”.

Në nenin 94¹/1 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikohet se: “Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”.

Procedura administrative konkrete pranë Komisionerit, është iniciuar mbi bazën e ankesës së paraqitur nga subjekti ankues, D. K., i cili, me anë të kërkesës së tij të mbajtur me procesverbal me datë 07.02.2024, është tërhequr nga ankesa e tij pranë KMD-së.

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, si dhe kërkesën për tërheqje nga ankesa të paraqitur nga ankuesi në datën 07.02.2024, Komisioneri vlerëson se, procedura për shqyrtimin e ankesës me nr. 13 regj., datë 01.02.2024, të paraqitur nga ankuesi D. K., kundër Policisë Bashkiake Tiranë, nuk mund të vazhdojë, por duhet të deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar, për shkak se

¹ “Tërheqja e ankesës”.

subjekti ankues është tërhequr nga ankesa dhe nuk identifikohet ndonjë interes publik që do të legjitimonte vazhdimin e procedurës, nga ana e këtij organi publik.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 32, pika 1, shkronja “a” dhe nenin 33, pika 1, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës me nr. 13 Regj., datë 01.02.2024, të D. K., për shkak se subjekti ankues është tërhequr nga ankesa pranë KMD-së.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Aftësia e kufizuar dhe çdo shkak tjetër)

(Fusha: Të mira dhe shërbime)